

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 578 Prot.

Tiranë, më 03.062016

VENDIM Nr. 42, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Alinura"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Alinura"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Vëzhgim arkeologjik (survey) në zonën përreth gjirit të Alinurës.
  - Gërmime sondazhi në monumentin e Alinurës. Do të zgjerohet sipërfaqja e gërmuar në vitin 2015.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë maj-qershor 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO